



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 60 Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 25 / 04 / 2023

**VENDIM**

Nr.10, datë 25 /04/2023

**PËR**

**RAPORTIN VJETOR PËR VITIN 2022 TË SHFRYTËZIMIT, OPERIMIT, MIRËMBAJTJES,  
MONITORIMIT DHE SIGURISË SË DIGAVE TË BASHKISË SHIJAK**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 25.04.2023 mori në shqyrtim Raportin vjetor për vitin 2022 në lidhje me shfrytëzimin, operimin, monitorimin dhe sigurinë e digave që administrohen nga Bashkia Shijak të paraqitur nga bashkia Shijak.

Në raportin vjetor është dhënë një informacion i detajuar në lidhje me gjëndjen e digës, të dhënat e monitorimit të saj, investimet e kryera gjatë vitit 2022, planet e gadishmërisë dhe ekipin e sigurisë së digës, problematikat kryesore gjatë vitit 2022 si dhe konkluzionet e shfrytëzuesit të digave në lidhje me gjëndjen e digave dhe sigurinë e tyre.

Në Raport **nuk është dhënë informacion në lidhje me hartat e përmblytjeve, matjet e volumet aktuale të ujit në rezervuar, problematikat në lidhje me sedimentet si dhe vlerësimi i aseteve të digës dhe të elementeve kryesore të saj** (Diga, Shkarkuesit fundor dhe sipërfaqësor, Vepra e marrjes, sistemet e monitorimit, rezervuari, etj)

Gjithashtu, sipas Raportit dhe rezultateve të dhëna rezulton se në përgjithësi të gjitha digat që janë nën administrim të kësaj bashkie nuk mirembahen dhe nuk monitorohen sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Në të gjitha digat nuk ka të instaluar sisteme të monitorimit të tyre dhe në shumicën e digave nuk kryhet pastrimi i skarpateve të sipërme dhe të poshtme. Në digat e Rubjekës, Bilalas, Koxhas, Pjezë ka probleme të mëdha në lidhje me rrëshqitjet, qëndrueshmërinë dhe sigurinë e tyre të cilat nuk janë zgjidhur akoma. Për asnjë prej digave nuk janë përgatitur planet e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile dhe nuk ka sisteme alarmi apo harta të përmblytjeve sipas kërkesave teknike dhe detyrimeve të KKDM. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

**VENDOSI:**

1- Ti kërkohet Bashkisë Shijak si shfrytëzuese e digave të mëdha që ndodhen në territorin e saj:

- Të përgatit dhe të dorëzoj për shqyrtim pranë KKDM projektet e zbatimit për rehabilitimin e digave të Rubjekës, Bilalas, Koxhas dhe Pjezë. Këto projekte duhet të plotësojnë kërkesat e VKM dhe legjislacionit në fuqi
- Të hartojnë Rregulloret e shfrytëzimit, monitorimit dhe sigurisë së digave sipas kërkesave të nenit 29 të VKM së lartpërmendura.
- Të marrë masat për mirembajtjen dhe monitorimin e digave të mëdha përmes sistemeve të monitorimit të kërkuara në nenet 32 dhe 33 të VKM përkatëse të dhëna me sipër dhe udhëzimeve të KKDM për pastrimin e të dy aneve të digave
- Të kryejnë matjet e volumeve aktuale të ujit në cdo rezervuar dhe të hartojnë kurbat e volumeve dhe të sipërfaqeve të ujit për rezervuarët deri në nivelin maksimal të ujit të parashikuar në projekt sipas kërkesave të nenit 30 të VKM se mesipërme,
- Të përgatit dhe të dorëzoj pranë KKDM një informacion në lidhje me vlerësimin e aseteve të digave dhe elementeve kryesore të tyre sipas udhëzimeve të KKDM-së
- Të përgatit planet e gadishmërisë në rastet e emergjencave civile për shkak të prishjes së mundshme të digës apo prurjeve maksimale që mund të vijnë në rezervuar. Këto plane duhet të jenë të shoqëruara me hartat e përmblytjeve sipas kërkesave të nenit 35 të VKM së mësipërme.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë Vendim sipas legjislacionit në fuqi. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**

